

ePeriodik

PUBLIKIM MUJOR, Nr. 161, Tetor 2022

“Shërbimet Financiare”, Progres Raporti i KE-së vlerëson përparimin e bërë nga AMF me kuadrin ligjor dhe rregullator

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar–shtator 2022
- Ecuria e tregut me pakicë të Titujve të Qeverisë për periudhën janar–shtator 2022
- Ecuria e tregut të pensioneve private vullnetare, 30.09.2022

Zhvillime të tjera

- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së takon përfaqësuesit e misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar
- Bruksel, AMF kryeson delegacionin shqiptar në takimet shpjeguese me BE për kapitullin 9 “Shërbimet financiare”
- AMF bashkëpunon në aktivitetin për edukimin financiar “Loja virtuale në bursë”

Publikime Profesionale

- Global Risk Regulator
- IAIS - publikohet për konsultim publik një material studimor lidhur me qëndrueshmërinë operacionale në sektorin e sigurimeve

Informacione Ndërkombëtare

Bullgari
Rumani

Poloni
Serbi

Qipro
Slloveni

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

“Shërbimet Financiare”, Progres Raporti i KE-së vlerëson përparimin e bërë nga AMF me kuadrin ligjor dhe rregullator



Komisioni Evropian, në Progres Raportin për Shqipërinë, publikuar më 12.10.2022, vlerëson përparimin e bërë me përafrimin ligjor e rregullator me acquis të BE-së dhe praktikat mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Në konstatimet e kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”, ku Autoriteti është institucioni lider, raporti nënvizon se “është bërë progres me sigurimet e detyrueshme dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Raporti nënvizon se “... është bërë progres me sigurimet e detyrueshme dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

“Në fushën e sigurimeve dhe pensioneve private, legjislacioni për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit është përafëruar me acquis më të rëndësishme të BE-së. Kuadri nënligjor u miratua gjatë periudhës së raportimit, duke mundësuar zbatimin e plotë të ligjit, përfshirë edhe një aplikacion për llogaritjen e dëmeve personale në rastet e aksidenteve rrugore,” nënvizon Progres Raporti.

Më tej, në dokument përmendet vendimi i Bordit të Autoritetit në shkurt 2022 për të lehtësuar masat e marra gjatë periudhës së pandemisë për të siguruar qëndrueshmëri financiare, duke pezulluar përkohësisht shpërndarjen e dividendit të shoqërive të sigurimit. Raporti nënvizon edhe aderimin e AMF-së në Memorandumin Shumëpalësh të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), për bashkëpunim ndërkombëtar në mbikëqyrje dhe shkëmbim informacioni.

Referuar infrastrukturës së tregjeve financiare, raporti konstaton se Bursa Shqiptare e Titujve, një entitet privat, vijon të operojë kryesisht me titujt e Qeverisë, Depozitari Qendror (AFISAR) është po ashtu në funksion, së bashku me gjithë infrastrukturën e pastregtimit. Raporti lë si rekomandim për t’u përmbytur finalizimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike për edukimin financiar dhe për zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

Edhe Progres Raporti i vitit 2021 vlerësonte progresin e bërë në kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, në veçanti përmes miratimit të ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit në mars të vitit 2021, si edhe masat e marra nga Autoriteti për garantimin e stabilitetit financiar të tregjeve nën mbikëqyrje gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.

Në 7 tetor 2022, AMF kryesoi delegacionin shqiptar që mori pjesë në takimet shpjeguese për kapitullin 9 të negociatave “Shërbimet financiare”, organizuar në Bruksel nga Komisioni Evropian. Në këtë takim, ekspertët e Komisionit Evropian bënë një prezantim të direktivave dhe kërkesave që duhet të plotësojë Shqipëria sa i përket kapitullit, ku institucione të tjera kontribuuese janë Banka e Shqipërisë, Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD).

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar–shtator 2022


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-shtator 2022 kapën vlerën 15,506 milionë lekë, ose 9.46% më shumë se në janar-shtator 2021. Gjatë periudhës janar-shtator 2022, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 981,393 me një rritje prej 15.49% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.83% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.08%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 38.44% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 61.56% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-shtator 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,773 milionë lekë, ose 7.70% më pak se në periudhën janar-shtator 2021.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-shtator 2022 kapën vlerën 3,280 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 8.45% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar – shtator 2022 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-shtator 2022 arritën rreth 9,546 milionë lekë, ose 11.10% më shumë se në periudhën janar-shtator 2021.

Ecuria e tregut me pakicë të Titujve të Qeverisë për periudhën janar–shtator 2022

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2022, u dominua në masën 54.02% nga transaksione në instrumente afatgjatë (*obligacione*) dhe 45.98% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 79.67% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.


Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për periudhën janar–shtator 2022, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim”, përkatësisht me 63.80% dhe 22.11% kundrejt vëllimit të përgjithshëm. Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për periudhën janar–shtator 2022 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.61% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar–shtator 2022, ka pasur një rritje prej 2,352 milionë lekë ose 129.59% krahasuar me periudhën janar–shtator 2021. Numri i transaksioneve i llojit B është rritur në masën 40.13%. Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar–shtator 2022, ka pasur një rritje prej 1,077 milionë lekë ose 69.48%, ndërkohë pati një ulje në numrin e transaksioneve në masën 4.64%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në totalin e transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku, vihet re një rritje në vlerë absolute me rreth 3,429 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar–shtator 2021.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Shtator 2022 (Në %)




Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për periudhën janar–shtator 2022, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim”,


Ecuria e tregut pensioneve private vullnetare, 30.09.2022

Gjatë periudhës janar-shtator 2022, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre katër fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30.09.2022 tregon një total asetesh neto prej 5,454.87 milionë lekë (46.78 milionë euro) dhe me një rritje prej 870.32 milionë lekë (18.98%) krahasuar me 31.12.2021. Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 30.09.2022 rezultoi 36,020 anëtarë duke shënuar një rritje prej 7.29% krahasuar me 31.12.2021.

Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve, 30.09.2022 (Në %)



Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve të fondeve të pensioneve, 30.09.2022 (Në %)



ZHVILLIME TË TJERA

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së takon përfaqësuesit e misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar



Autoriteti ka treguar vëmendje të shtuar në monitorimin e treguesve kryesorë financiarë të subjekteve nën mbikëqyrje. Ai veçoi vendimet e Bordit të AMF-së për të adresuar efektet vijuese të situatës së tregjeve financiare dhe presionet rritëse të normave të interesit.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete, zhvilloi një takim me misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të kryesuar nga znj. Yan Sun, shefe e Misionit për Shqipërinë. Bisedimet u përqendruan te zhvillimet e fundit në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, ndikimet e faktorëve të jashtëm dhe luhatshmëria e tregjeve financiare, si edhe masat e marra nga Autoriteti.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, duke u ndalur te ecuria e tregjeve nën mbikëqyrje, vlerësoi se ndikimet kryesore si pasojë e luhatjes së tregjeve financiare botërore, rritjes së inflacionit dhe normave të interesit janë reflektuar kryesisht te fondet e investimit, ndërsa në tregjet e sigurimeve dhe pensioneve private efektet deri tani kanë qenë të kufizuara.

Z. Mete theksoi se Autoriteti ka treguar vëmendje të shtuar në monitorimin e treguesve kryesorë financiarë të subjekteve nën mbikëqyrje. Ai veçoi vendimet e Bordit të AMF-së për të adresuar efektet vijuese të situatës së tregjeve financiare dhe presionet rritëse të normave të interesit.

Shefja e Misionit të FMN-së për Shqipërinë, znj. Yan Sun vlerësoi rolin e Autoritetit si edhe masat e marra prej tij në funksion të garantimit të stabilitetit financiar dhe amortizimit të ndikimeve në tregjet nën mbikëqyrje. Ajo kërkoi ushtrimin e një kujdesi të shtuar monitorues, marrë në konsideratë se situata ndërkombëtare mbetet e paqartë dhe presionet inflacioniste parashikohet të jenë të pranishme. Në këtë drejtim, pjesëmarrësit në takim ndanë qëndrimin se monitorimi në vijimësi dhe mënyrë të kujdesshme i situatës, bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare dhe autoritetet homologe për realizimin e ndërhyrjeve të matura dhe të duhura rregullatore, është me rëndësi të veçantë për adresimin e efekteve të mundshme në tregjet financiare nën mbikëqyrje.

Në përfundim, Z. Mete falenderoi Fondin Monetar Ndërkombëtar për bashkëpunimin e vazhdueshëm me Autoritetin, edhe në kuadër të misioneve të asistencës teknike dhe shprehu gadishmërinë për të thelluar më tej marrëdhëniet e mira mes dy institucioneve.

Bruksel, AMF kryeson delegacionin shqiptar në takimet shpjeguese me BE për kapitullin 9 “Shërbimet financiare”



Avancimi ligjor dhe rregullator i ndërmarrë nga Autoriteti u nënvizua edhe në Raportin e fundit të Progresit, të Komisionit Evropian, publikuar në vitin 2021

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ishte kryesues i delegacionit shqiptar që mori pjesë në takimet shpjeguese për kapitullin 9 të negociatave “Shërbimet financiare”, organizuar në Bruksel nga Komisioni Evropian. Gjatë takimit ku Autoriteti u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, z. Ervin Mete, në cilësinë e negociatorit të kapitullit 9, u theksua se është thelbësore përgatitja për procesin e negociimit të kapitujve dhe përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE.


Takimi u hap nga Drejtuesi i ekipit për Shqipërinë në Drejtorinë e Përgjithshme të Fqinjësisë dhe Zgjerimit në Komisionin Evropian, z. Vincent Rey, si edhe nga fjalët përshëndetëse të znj. Majlinda Dhuka, Ministre Shteti dhe Kryenegociatore e Shqipërisë, si edhe znj. Drita Abdiu Halili, Zv/Kryenegociatore e Maqedonisë së Veriut.

Më tej, ekspertët e Komisionit Evropian bënë një prezantim të direktivave dhe kërkesave që duhet të plotësojë Shqipëria sa i përket kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”. *Acquis* në këtë kapitull rregullon shërbimet financiare në fushën bankare, atë të sigurimeve, pensioneve vullnetare, shërbimeve të investimeve dhe tregjeve të titujve. Së bashku me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, institucione të tjera kontribuuese në këtë kapitull janë Banka e Shqipërisë, Instituti i Statistikave (INSTAT), si edhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD).

Përgjatë viteve të fundit është ndryshuar një pjesë e konsiderueshme e ligjeve për tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, duke i përafruar me Direktivat dhe kuadrin ligjor evropian. Në vitin 2020 u miratuan ligjet e reja për tregjet e kapitalit, sipërmarrjet e investimeve kolektive, si edhe për tregjet financiare të bazuar në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë. Ndërsa në vitin 2021 u miratua ligji i ri për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit. Projektligji i ri për fondet e pensioneve private është në pritje të miratimit nga Këshilli i Ministrave.

Avancimi ligjor dhe rregullator i ndërmarrë nga Autoriteti u nënvizua edhe në Raportin e fundit të Progresit, të Komisionit Evropian, publikuar në vitin 2021. Në gjetjet e Kapitullit 9-të “Shërbimet Financiare”, raporti thekson se “është bërë progres në lidhje me rekomandimet e vitit të kaluar përmes miratimit të ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

AMF bashkëpunon në aktivitetin për edukimin financiar “Loja virtuale në Bursë”



Skudrat pjesëmarrëse nga vende të ndryshme të botës do të hyjnë në një platformë virtuale të centralizuar, dhe me fonde virtuale, do të mund të investojnë në tituj me çmime reale tregtimi.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mori pjesë, më 25 tetor, në eventin që shënoi fillimin e lojës virtuale të bursës “Të mësojmë për Bursën” (*Stock Market Learning Competition, SML*), organizuar nga Fondacioni Gjerman Sparkassen për Bashkëpunim Ndërkombëtar (DSIK Albania) dhe Shoqatën e Tregtimit të Titujve në Shqipëri (ASTA). Ky është viti i dytë që skuadrat nga universitetet shqiptare, publike e private, marrin pjesë në këtë konkurs ndërkombëtar. Këtë vit, për herë të parë, do të marrin pjesë disa ekipe nga Maqedonia e Veriut, duke krijuar kështu jo vetëm një numër më të madh skuadrash pjesëmarrëse, por edhe diversitet në ndërtimin e portofoleve të investimit.

Ky vit shënon gjithashtu edhe 40 vjetorin e zhvillimit të kësaj loje edukative të lidhur me njohuritë financiare e cila përgatit studentët dhe skuadrat pjesëmarrëse me shumë informacione të vlefshme për bursën, tregtimin e titujve dhe në përgjithësi njohuritë mbi tregjet e kapitalit, minimizimin e risqeve në këto tregje dhe arritjen e normave të fitimit.

Duke përgëzuar skuadrat pjesëmarrëse në këtë, Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtorë Ekzekutive e AMF-së vlerësoi angazhimin e të rinjve për të thelluar dhe për të përdorur në praktikë njohuritë për tregjet e kapitalit, të marra gjatë studimeve universitare. Ajo u shpreh se Eksperienca e vitit të kaluar, tregoi se disa skuadra luajtën fort, bënë mjaft transaksione, dhe “fituan” por edhe “humbën”. Skuadrat që morën riskun më të madh gjatë këtyre transaksioneve, mësuan më shumë se si të lundrojnë në bursë edhe pse thjesht në kuadrin e një loje virtuale. Znj. Kaçi theksoi se “... ky informacion sot do t’ju shërbejë për t’u pajisur me njohuri të nevojshme, për të mos qenë vetëm konsumatorë, por edhe investitorë të së nesërme në tregjet e gjelbra financiare. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe financiar pret nga ju njohuri, guxim dhe minimizimin e rrezikut.”

Përgjatë konkursit, skuadrat pjesëmarrëse nga vende të ndryshme të botës do të hyjnë në një platformë virtuale të centralizuar, e cila do t’i pajisë me fonde virtuale, që mund t’i investojnë në tituj me çmime reale tregtimi. Në fund, një juri e profesionale do të vlerësojë performancën e portofoleve virtuale të investimeve dhe do të shpallë skuadrën fituese.

Global Risk Regulator

A SERVICE FROM THE BANKER

Central bank
digital
currencies
Benefits if done right



Subjects / Financial Markets

DeFi stands out as crypto's biggest regulatory challenge

Justin Pugsley | October 20, 2022



Decentralised finance is one of the most difficult areas of crypto to regulate and could pose systemic risks if it becomes deeply embedded in the traditional financial system, central bankers warned.

DiFi janë sfida më e madhe e rregullatorëve për kriptot

Justin Pugsley

Artikulli përshkruan arsyet e një paralajmërimi të bërë nga bankat qendrore, se si financat e decentralizuara (De Fi) janë një nga zonat më të vështira të kriptove për t'u rregulluar dhe ato mund të paraqesin edhe rreziqe sistemike nëse përfshihen thellësisht në financat tradicionale.

Global Risk Regulator

<https://www.globalriskregulator.com/>

IAIS publikon për konsultim publik një material studimor lidhur me qëndrueshmërinë operacionale në sektorin e sigurimeve



Qëndrueshmëria operacionale është bërë një fushë gjithnjë e më e rëndësishme ku po përqendrohet vëmendja, veçanërisht në dritën e zhvillimeve të shpejta të teknologjisë dhe inovacionit, të ndryshimeve në mënyrën se si njerëzit punojnë, dhe të një peizazhi në rritje të kërcënimit kibernetik. Koncepti i qëndrueshmërisë operacionale mund të mos jetë i ri për siguruesit, e megjithatë po pranohet rëndësia e përshtatjes së regjimeve mbikëqyrëse për të llogaritur qëndrueshmërinë në rritje të siguruesve në sistemet dixhitale, adoptimin dhe zbatimin e teknologjive të reja dhe potencialin për firmat e sigurimit që të mbështeten tek palët e treta, si ofrues për të ndihmuar në zbatimin dhe mbështetjen e saj.

<https://www.iaisweb.org/2022/10/public-consultation-on-issues-paper-on-insurance-sector-operational-resilience/>

Në përgjigje të këtyre tendencave në zhvillim, IAIS ka ngritur një grup pune i cili ka publikuar për konsultim një material studimor mbi Qëndrueshmërinë Operacionale në Sektorin të Sigurimeve. Dokumenti identifikon çështjet që ndikojnë në elasticitetin operacional në sektorin e sigurimeve dhe jep shembuj se si mbikëqyrësit po u qasen këtyre zhvillimeve, duke marrë parasysh mësimet e nxjerra gjatë pandemisë Covid-19.

Duke pranuar se qëndrueshmëria operacionale është një fushë e gjerë dhe në zhvillim, dokumenti trajton tre nën-tema specifike të elasticitetit operacional:

- (i) Qëndrueshmëria kibernetike;
- (ii) Shërbimet e marra nga palët e treta;
- (iii) Menaxhimi i vazhdimësisë së biznesit.

BULLGARI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave zyrtare të ofruara nga Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare – FSC të Bullgarisë, tregu i sigurimeve në vend, në fund të qershorit 2022, arriti në rreth 1.8 miliardë BGN ose 918 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 9.8% krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2021. Numri i kompanive të sigurimeve aktive në Bullgari nga 51 një vit më parë, ka rënë në 44 në fund të qershorit 2022.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jetës u rrit me 7.7% krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2021, duke arritur në vlerën e 163.3 milionë euro. Të gjitha klasat shënuan një tendencë pozitive modeste, përveç produkteve UL (produktet e sigurimit të lidhura me skema investimesh) të cilat patën një rënie prej 2.6% të primeve.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rrit me 10.3% duke arritur në 754.7 milionë euro. Në sigurimet e Jo-Jetës, klasa e sigurimit të pronës "Dëmtime të pronës", përfshirë sigurimet bujqësore, si dhe sigurimi Kasko në sigurimet motorike, patën ritmet më të forta të rritjes dyshifrore.

POLONI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare Polake (KNF), në gjysmën e parë të 2022 tregu i sigurimeve realizoi një vëllim të primeve të shkruara bruto me një rënie të vogël prej -0.5% krahasuar më të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kështu vëllim i primeve të shkruara bruto arriti në 7.57 miliardë euro. Statusi i paqartë i tregut u përcaktua tërësisht nga segmenti i sigurimit të Jetës, i cili pati një rënie prej -8.3% të vëllimit të primeve.

Në përgjithësi, vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës arriti në 2.23 miliardë euro, ndërsa pesha e tij në totalin e tregut ra nga 32% në 29.5%, në fund të qershor 2022.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rrit, me 3.14% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 duke arritur në 5.33 miliardë euro. Sigurimi i aksidenteve, sëmundjeve, sigurimi MTPL, sigurimi i pronës ishin klasat që raportuan rritjen më të madhe.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas publikimeve zyrtare të Shoqatës së Sigurimeve të Qipros, IAC, vëllimi i primeve të shkruara bruto për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 për siguruesit e Qipros arriti në 528.9 milionë euro, duke u rritur me rreth 11% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Segmenti i sigurimit të Jo-Jetës arriti në 266.6 milionë euro duke shënuar rritje me 3.4% në vit, ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës realizoi 262.3 milionë euro, ose 19.9% më shumë se të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ndërkohë që vlera e dëmeve bruto ishte 228.9 milionë euro, me një rritje prej 7.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, nga të cilat 111.7 milionë euro lidhen me sigurimin e Jetës, 62.2 milionë euro dëme i përkisnin sigurimit motorik, 32.2 milionë euro lidheshin me policat e sigurimit për aksidente dhe shëndetësi dhe 13.1 milion euro – lidheshin me policat e sigurimit nga zjarri.

RUMANI

www.xprimm.com

Sipas autoritetit mbikëqyrës në Rumani, ASF, vëllimi i primeve të shkruara bruto në gjysmën e parë të vitit 2022 për siguruesit rumunë arriti në 8.76 miliardë RON ose rreth 1.77 miliardë euro. Duke marrë parasysh edhe primet e shkruara bruto nga kompanitë që operojnë në vend bazuar në të drejtat e Lirisë së Shërbimit (FOS) dhe Lirisë së Krijimit (FOE), vlera totale e tregut lokal rritet në 1.92 miliardë euro.

Duke parë ecurinë e biznesit për kompanitë e licencuara në Rumani, pra nën mbikëqyrjen e autoritetit rumun të tregut, vëllimi i primeve të shkruara bruto për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 tregoi një rritje prej 36.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Pjesa më e madhe e kësaj rritje vjen nga sigurimet e Jo-Jetës.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës u rrit me 43.5%, duke arritur në 1.47 miliardë euro. Kontributi më i lartë në rritjen e tregut erdhi nga linja MTPL, për të cilën vëllimi i primeve u rrit me mbi 82%, kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve të policave MTPL krahasuar me një vit më parë. Primet e sigurimit të Jetës u rritën me 11%, duke arritur në 300 milionë euro.

Kompanitë që operojnë në Rumani bazuar në të drejtat e Lirisë së Shërbimit (FOS) dhe Lirisë së Krijimit (FOE) kishin siguruar në tregun vendor prime në vlerën 730 milionë RON (147.6 milionë euro). Këto kompani ishin aktive kryesisht në linjën MTPL, ku pesha e tyre në totalin e ndërmjetësimit është pothuajse 41%. Klasa e dytë e rëndësishme nga ky këndvështrim është klasa A9 (sigurime bujqësore), me një peshë mbi 20%.

Vlera mesatare e MTPL ka ardhur drejt stabilizimit. Në fund të qershorit 2022, primi mesatar për sigurimin MTPL, të blerë nga personat fizikë ishte 904 lei, nga 913 lei në fund të marsit 2022. Në përgjithësi (si për personat fizikë dhe juridikë), primi mesatar ishte 1,138 lei në mars dhe arriti në 1,154 lei në 30 qershor 2022.

SERBI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara në faqen online të Bankës Kombëtare të Serbisë, NBS, tregu serb i sigurimeve u zgjerua me rreth 12% gjatë gjashtëmujorit të parë 2022 duke arritur vlerën e rreth 575.5 milionë euro. Vëllimi i primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jo-Jetës u rrit me 14% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 459.4 milionë euro. Ndër primet në sigurimin e Jetës u rritën me 4% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar.

Vlera e dëmeve të paguara u rrit me 19.5% nga të cilat rritjen më të dukshme e kishin sigurimet e lidhura me klasat e Jo-Jetës që patën një rritje prej 26.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Siguruesit slovenë raportuan një rritje të vëllimit të primeve të shkruara bruto në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 me 4.62% duke arritur vlerën e 1.48 miliardë euro. Përcaktuesi kryesor i tendencës rritëse ishte segmenti i sigurimit të Jo-Jetës, i cili pati një normë rritjeje të primeve bruto prej 6.3%, duke arritur në 1.08 miliardë euro. Në sigurimet e Jo-Jetës, sigurimi i pasurisë dhe linjat e sigurimit motorik, sidomos sigurimi Kasko dhanë kontributet më të mëdha në rritjen e primeve.

Segmenti i sigurimit të Jetës mbeti, në përgjithësi, në nivelin e vitit 2021, prej 393.6 milionë euro. Megjithatë, duhet theksuar se linja e produkteve "Unit-Linked" sigurimi i Jetës i lidhur me skemat e investimeve shënoi një rritje prej 7.6% të primeve, duke kompensuar tendencën negative të linjave tradicionale të sigurimit të Jetës.

Dëmet e paguara u rritën me rreth 11.67%, duke arritur në 906 milionë euro, kryesisht të nxitura nga linja e sigurimeve shëndetësore.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | ëëë.amf.gov.al